

Këngë Kreshnikësh: lindja nën sytë e Sigurimit
Studiuesi Robert Elsie boton përkthimin në anglisht të 23 këngëve
nga eposi i kreshnikëve

Vëllimi aktual i ofron lexuesit një përzgjedhje nga cikli i njohur i eposit shqiptar, “*Songs of the Frontier Warriors*” (Këngë Kreshnikësh). Si fryt i një kulture pak të njohur dhe i një gjuhe të vështirë e pak të studiuar, eposi shqiptar ka qenë i prirur të mbetet në hijen e eposit serbokroat, apo më së shumti, në atë të eposit boshnjak, me të cilin ka gjasime të pamohueshme. Si rrjedhim, ky përkthim mund të konsiderohet si një orvatje fillestare për të korrigjuar çekuilibrin dhe për t’iu dhënë studiuesve dhe lexuesve në përgjithësi, një mundësi për të gjurmuar botën ekzotike të fiseve veriore shqiptare.

Ky botim i poemave epike shqiptare në përkthimin anglisht, përfshin 23 këngë të bazuara në Visaret e Kombit, botim i vitit 1937 nga Bernardin Palaj dhe Donat Kurti. Këngët janë të gjata nga 80 deri 674 vargje.

Shumë është shkruar për lashtësinë dhe origjinën e eposit shqiptar dhe për marrëdhëniet e tij me eposin boshnjak. Nisur nga rrëfenja dhe për motive të tjera, mbretëron ideja në ditët tona se Këngët e Kreshnikëve u kristalizuan në shekujt 17 dhe 18 në kufirin e rajonit të Ballkanit i cili ndante botën e krishterë nga bota islamike, sadoqë tek këngët janë prezente edhe shtresa shumë më të vjetra. Kështu kemi të bëjmë me një përpunim letrar të lufrave turke (*Türkenkriege*) ndërmjet Perandorisë Osmane dhe të Habsburgëve. Heronjtë tanë janë rebelë myslimanë të cilët jetojnë në “krahinë” dhe kënaqen nga kapërcimi i maleve drejt mësymjes në “krajli,” mbretërinë e të krishterëve, dhe duke vënë përpara mbretin e luftëtarët e tij sllavë. Emrat e vendeve referuar këngëve, Jutbina dhe Kotorr i Ri etj, u identifikuan në krahinën e Lika-s dhe Krbava-s, lugaja në lindje të Zarës në Kroaci, jo larg nga kufiri i sotëm boshnjak. Përmendet gjithashtu Lumi Danub dhe rojet hungareze, gjithçka që është e largët nga zonat e vendbanimit tradicional shqiptar. Nisur nga kjo dhe nga termat e spikatura sllave në disa këngë, mund të duket qartë se kemi të bëjmë me një trung të lëndës orale i cili, ka shumë mundësi që pas shekujsh zhvillimi, u kristalizua në mjedisin sllav jugor dhe i cili më pas do të transmetohej (disa do të thoshin “do të kthehej”) në mjedisin shqiptar nga këngëtarët dygjuhësh. Është e kuptueshme se ekzistojnë shumë paralele ndërmjet eposit shqiptar dhe atij boshnjak. Ata kanë një origjinë të përbashkët dhe, në thelb, reflektojnë një kulturë të përbashkët. Megjithatë, pas transmetimit, eposi shqiptar është zhvilluar në një mjedis krejtësisht shqiptar dhe mori karakteristika, vlera dhe forma jashtëgjuhësore të shprehjes krejtësisht shqiptare, dhe kjo gjë e bëri atë veçanerisht magjepsës. Ndonëse toponimet mbetën të njëjta, konflikti është zhvendosur nga beteja ndërmjet myslimanëve dhe të krishterëve në betejën ndërmjet shqiptarëve dhe sllavëve.

Studiuesit shqiptarë, që pohojnë përparësinë kohore e kulturës së tyre mbi atë sllave, argumentojnë duke përmendur disa elemente të vjetra të kulturës heroike shqiptare të cilat mund të kenë ndikuar në përpunimin e këtyre vargjeve shumë më herët se perudha e kristalizimit. Ata theksojnë se vargjet epike të këtij tipi u përpunuan vetëm ndërmjet fiseve sllave që jetonin gjeografikisht në afërsi me vendasit, pra stërgjyshët e shqiptarëve, dhe disa kanë pretenduar për një shtresë parasllave. Megjithatë, fatkeqësisht, për origjinat e vargjeve epike të Ballkanit debatet janë zhvilluar në një mënyrë tipike ballkanase, sipas linjes “Isha unë i pari!” Pas shekujsh zhvillimi dhe kontaktesh paralele, vështirë të percaktojmë një tablo të qartë të shtresëzimit të poemës epike.

Pavarësisht nga transmetimi nga një mjedis sllav boshnjak, Këngët e Kreshnikëve nuk janë thjesht përkthime të këngëve epike serbokroate. Ato kanë pësuar pandërprerë një zhvillim të pavarur prej periudhës së kristalizimit, kështu që nuk janë as boshnjake, as malazeze, as të Hercegovinës, as serbe, madje as të jugut të Shqipërisë, por janë një produkt i gjenisë krijuese

të malësisë veriore shqiptare.

Eposi serbokroat, si një traditë e gjallë, duket të jetë zhdukur që nga ditët e Parry-t dhe Lord-it. Nuk ka më këngëtarë të pashkollë që të gjenden në kafenetë e Novi Pazarit apo Bijelo Polje-s dhe nuk ka më asnjëri të aftë të vazhdojë më tej traditën orale të sllavëve të jugut. Eposi shqiptare, megjithatë, - shumë njerëz i lë të habitur kjo, - është ende gjallë dhe ngazëllyes.

Edhe në fillim të shekullit 21-të gjindet një numër i mirë lahutarësh në Kosovë, veçanërisht në malësinë e Rugovës, në lindje të Pejës, dhe në veriun e Shqipërisë, po aq sa edhe disa individë të rrallë në Malin e Zi, të cilët janë të zotë të këndojnë dhe të recitojnë veprat heroike të Mujit dhe Halilit dhe të tridhjetë agallarëve. Janë këngëtarë të cilët kanë trashëguar repertorin e tyre si pjesë të padëmtuar e të vazhdueshme të traditës gojore, që është përcjellë nga njëri brez në tjetrin. Ndonëse janë afër pleqërisë, këta shqiptarë janë këngëtarët e fundit të këngëve epike në Evropë!

Fatkeqësisht, vitet 1997-1999 të luftës në Kosovë lanë shenja të thella, veçanërisht në atdheun e sotëm të eposit, malësia e Rugovës. Shumë fshatra shqiptare u shkatërruan nga fqinjët e tyre sllavë që kishin ardhur nga përtej maleve, nga Mali i Zi, për të sulmuar e grabitur. Pas kësaj, shumica e vendbanimeve u shkatërruan sistematikisht nga trupat dhe paraushtarakët serbe. Popullsia u dëbua e gjitha, dhe shumë fshatarë kane marrë arratinë në këmbë dëborës së dendur në dimër. Të panumërt ishin shqiptarët e grabitur, dhunuar dhe të vrarë, ndërsa braktisnin fshatrat e tyre që digjeshin, dhe është e lehtë të mendosh se barra më e madhe binte mbi të moshuarit. Është ende shumë herët për të vlerësuar atë goditje të papërmbajtur dhe atë shkatërrim mbi kulturën fisnore tradicionale të malësisë së Rugovës.

Shqiptarët e Kosovës janë, megjithatë, shumë të lidhur me vendin e tyre dhe me traditat kombëtare, shumë më tepër nga ç'janë njerëzit në Republikën e Shqipërisë. Në Shqipëri, kultura vendase e maleve veriore ka marrë goditjen e fundit nga viti 1997, i cili përfundoi me një valë të gjerë emigrimi të popullsisë së malësisë për në Tiranë, Durrës dhe në qytete të tjera bregdetare.

Duke e mbyllur, do të doja të shtoja pak shënime personale lidhur me origjinën e këtij libri. Në maj të vitit 1988, gjatë viteve të fundit të diktaturës staliniste në Shqipëri, ia dola mbanë të marrë një vizë për të vizituar vendin disa javë për qëllime studimi. Vështirësitë për sigurimin e vizës u kompensuan më se shumti me mikpritjen e shoqëruesve të mi shqiptarë, kur unë më në fund mbërrita në Tiranë. Akademia e Shkencave përmbushi çdo dëshirë timen ndërsa isha në Shqipëri, madje më vuri në dispozitë një makinë dhe një shofer për të më çuar për dyqind metra rrugë nga hoteli në Bibliotekën Kombëtare. Pikërisht gjatë kësaj vizite, takova profesorin Qemal Haxhihasani (1916-1991), një nga specialistët kryesorë shqiptarë për eposin dhe këngët heroike. Takoheshim në kafënë e njohur të Hotel Dajtit. Në atmosferën shtypëse të kohës dhe histerinë kundër Perëndimit që asokohe mbretëronte në Shqipëri, ishte më tepër se e guximshme nga ana e profesor Haxhihasanit të më takonte hapur. Çdo takim me një të huaj, siç mësova më vonë, mund të kishte pasoja për t'u marrë në pyetje me ditë e netë nga policia sekrete e gjithpushtetshme, Sigurimi.

Haxhihasani shprehu gëzimin e tij për interesin tim për eposin shqiptar dhe foli me krenari, megjithese me zë të ulët, për takimin e tij me Albert Lord-in, shumë vite më parë.

Ishte entuziasmi i tij i çlirët për Këngët e Kreshnikëve i cili e sollti në jetë këtë projekt, të lindur, si të thuash, nën syrin vigjëlues të Sigurimit. Në takimin e dytë, ai më bëri propozime konkrete për përkthimin dhe më pajisi me libra dhe materiale të nevojshëm për këtë projekt.

Haxhihasani vdiq tre vjet më vonë, pak pas rënies së diktaturës, dhe shumë vite kanë kaluar nga ajo kohë. Disa projekte të tjera të miat gjetën përparësi dhe faqet e hershme të përkthimit u mbuluan nga pluhuri në raft, para se unë të gjeja mundësinë për ta përfunduar.

Duhet të pranoj se kjo vonesë kishte të bënte edhe me pamundësinë time asokohe për t'u përballuar me dialektin geg dhe me stilin madhështor me të cilin Këngët e Kreshnikëve u

hartuan. Të gjesh një formë adekuate për përkthimin e këngëve heroike nga një kulturë e tillë e huaj nuk ka qenë punë e lehtë.

Mbetet shumë për t'u bërë në fushën e këngëve epike shqiptare dhe vëllimi i sotëm mund të jetë vetëm një hap i vogël për më tej. Nëse ky vëllim do të arrijë të ngjallë interes në këtë fushë, para se kultura heroike e malësise shqiptare të jetë zhdukur përgjithmonë, qëllimi i tij do të përmbushet.

[Marrë nga hyrja e librit *Songs of the Frontier Warriors, Këngë Kreshnikësh: Albanian epic verse in a bilingual English-Albanian edition. Edited, introduced and translated from the Albanian by Robert Elsie and Janice Mathie-Heck* (Bolchazy-Carducci Publishers, Wauconda, Illinois, 2004) dhe botuar në *Shekulli*, Tiranë, 4 shkurt 2004, f. 19, ribotuar në *Bota Shqiptare*, Romë, Nr 101, 12-25 shkurt 2004, f. 14. Përkthyer nga Elsa Demo / Taken from the introduction to the volume *Songs of the Frontier Warriors, Këngë Kreshnikësh: Albanian epic verse in a bilingual English-Albanian edition. Edited, introduced and translated from the Albanian by Robert Elsie and Janice Mathie-Heck* (Bolchazy-Carducci Publishers, Wauconda, Illinois, 2004) and published in *Shekulli*, Tirana, 4 February 2004, p. 19, republished in *Bota Shqiptare*, Rome, No. 101, 12-25 February 2004, p. 14. Translated by Elsa Demo.]